

Nr. 13/1 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje13 MAY 2019
Nr. 2253 Prot.Tiranë, më 13/05 2019**VENDIM**Nr. 04 , Datë 24 / 04 / 2019**PËR****PËR MIRATIMIN NË PARIM TË RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME TË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETIT TREGTAR NGA KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, KESH SH.A.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statutit të shoqërisë KESH sh.a., pikës 4/1 të nenit 5 të Vendimit Nr. 244, datë 30.3.2016 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Nr.2762/8, datë 06.06.2018 "Mbi miratimin e rregullores së tregtimit të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a" dhe bazuar në propozimet e Administratorit të KESH sh.a., Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e tij të datës 24/04/2019,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të Rregullave të Përgjithshme të Organizimit të Aktivitetit Tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja në fuqi, miratuar me Vendim Nr. 2 , datë 23.01.2018, të Këshillit Mbikqyrës të KESH sh.a. "Për tregtimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.", shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.
3. Kjo rregullore dhe relacioni përkatës, së bashku me këtë vendim, t'i paraqitet për miratim përfundimtar Asamblesë së Aksionerëve.
4. Ngarkohet Administratori i KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Evis MAMAJ	Kryetare
Gjergji SIMAKU	Zv/Kryetar
Sindi DUSHKU	Anëtare
Albana SHKURTA	Anëtare
Luigj PJETRI	Anëtar



**RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETIT TREGTAR NGA
KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SH.A**



Përmbajtja

Objekti dhe Qëllimi	3
Përkufizime	3
Parimet kryesore të ushtrimit të aktivitetin tëtregtimit/furnizimit të energjisë elektrike	4
Regjistrimi në regjistrin e pjesëmarrësve në procedurën e tregtimit të energjisë elektrike	5
Tregtimi/Furnizimi i energjisë elektrike	5
Kërkesa/Ftesa për ofertë	6
Deklarata e konfliktit te interesave	6
E drejta e ankimit	6
Monitorimi i procedurave	6
Sanksione	7
Miratimi dhe ndryshimi	7
Dispozita kalimtare	7
Hyrja në fuqi	7



Neni 1 Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet bazuar në parashikimet te neneve 51 dhe 79 të ligjit Nr. 43/2015, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar, Statutit të Shoqërisë KESH sh.a si edhe legjislacionit civil të detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 Objekti dhe Qëllimi

2.1 Objekti i kësaj rregullore është të përcaktojë rregullat e përgjithshme që i mundësojnë shoqërisë zhvillimin e aktivitetit tregtar në sektorin e energjisë elektrike.

2.2 Qëllimi i kësaj rregullore është:

- a) ti mundësojë shoqërisë zhvillimin e procedurave dhe pjesëmarrjen në procedurat që zhvillohen nga subjekte të licencuara, në formë me mjete elektronike, në mënyrë të thjeshtëzuar, eficiente dhe bazuar në praktikat më të mira të biznesit;
- b) të nxisë pjesëmarrjen e subjekteve të licencuar në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike të iniciuara nga vetë shoqëria, si edhe të nxisë shoqërinë të marrë pjesë në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen në formë elektronike nga subjekte të licencuara;
- c) të nxisë konkurrencën në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike dhe të jetë konkurrues për mënyrën e çmim-formimit dhe paraqitjes së ofertës në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen në formë elektronike nga subjekte të licencuara;
- d) të garantojë transparencë, barazi, besueshmëri, konfidencialitet dhe mjedis konkurrues gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e përdorur me poshtë do të kenë kuptimin:

3.1 KESH: do të thotë shoqëria Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a si subjekt i licencuar për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike;

3.2 Autoriteti Kontraktues "AK": do të thotë KESH në aktivitetit të prodhimit, tregtimit dhe zhvillues i procedurave të tregtimit të energjisë elektrike me mjete elektronike;

3.3 Operatori Ekonomik (ofertues) "OE": do të thotë KESH si pjesëmarrësnë procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen me mjete elektronike nga subjekte të licencuara si dhe KESH si furnizues i energjisë elektrike për klientët fundorë nëpërmjet procedurës së negociimit të drejtpërdrejtë.

3.4 Subjekt i licencuar: do të thotë pala tjetër (counterparty) në një marrëdhënie tregtare me KESH, i licencuar për prodhimin, tregtimin, furnizimin e energjisë elektrike/operimin e rrjeteve dhe që ushtron aktivitetin e saj brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3.5 Klient Fundor: do të thotë një klient që nuk përfiton nga shërbimi universal i furnizimit, dhe i cili nëpërmjet negociimit të drejtpërdrejtë me KESH sh.a blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

3.6 Titullari i "AKs"/ "OE" do të thotë Administratori i Shoqërisë KESH sh.a. ose personi i autorizuar prej tij në mënyrë të dokumentuar.

3.7 Tregtimi i energjisë elektrike: do të thotë tërësia e veprimeve të kryera nga KESH për kalimin e ndërsjellë nga shitësi tek blerësi, të energjisë elektrike sipas kushteve të negociuara dhe pranuar nga



palët në kontratën përkatëse të shitjes dhe/ose blerjes së energjisë elektrike referuar legjislacionit në fuqi në RSH.

3.8 Furnizim i energjisë elektrike: do të thotë shitja e energjisë elektrike të klientët bazuar në çmime të negociuara në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në përputhje me kushtet e përgjithshme/veçanta të parashikuara në kontratën e negociuar lirisht nga palët.

3.9 Procedurë tregtimi/furnizimi e energjisë elektrike: do të thotë tërësia e veprimeve të kryera nga KESH për shitjen/blerjen/furnizimin e energjisë elektrike nga/tek subjektet e licencuara nëpërmjet mjeteve elektronike dhe/ose negociimit të drejtpërdrejtë.

3.10 Pjesëmarrës i regjistruar: do të thotë një subjekt i licencuar që plotëson kushtet dhe kriteret për regjistrimin, dhe i cili është kualifikuar dhe regjistruar në regjistrin pjesëmarrësve në procedurat që zhvillohen nga KESH për shitjen/blerjen e energjisë elektrike.

3.11 Regjistri i pjesëmarrësve: do të thotë një regjistër ku regjistrohen dhe përditësohen të dhënat e të gjithë subjekteve të licencuara, të kualifikuar për pjesëmarrje në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen nga KESH.

3.12 Produkt tregtimi/furnizimi: do të thotë energjia elektrike që mund të tregtohet/furnizohet dhe e përcaktuar në kapacitet, sasi, periudhë lëvrimi, profil, etj.

3.13 Kërkesa/Ftesa për ofertë: dokumenti zyrtar me ane të të cilit "AK" dhe "OE" i shpreh interesin subjektiv të licencuar/klientit fundor.

3.14 Ofertë: do të thotë tërësia e dokumenteve, të dërguar me mjete elektronike drejt "AK" ose prej "OE" me anë të së cilës një shprehet interesi për shitje/blerje/furnizim me energji elektrike.

3.15 Ofertues: do të thotë "KESH" dhe/ose "Subjekt i licensuar" që paraqet një ofertë nëpërmjet mjeteve elektronike.

3.16 Kushtet e përgjithshme tregtare: do të thotë tërësia e elementëve/kushteve standarde në përmbajtje të kërkesës standarde për shprehje interesi që nënshkruhet nga subjektet e licencuara gjatë procesit të regjistrimit në regjistrin e subjekteve të licencuar të kualifikuar për pjesëmarrje në procedurat që zhvillohen nga "AK", ose ato që "OE" nënshkruan si pjesë e procedurës për regjistrimin në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen me mjete elektronike nga subjekte të licencuara për shitjen/blerjen e energjisë elektrike.

3.17 Kushte të veçanta tregtare: do të thotë elementët/kushtet e veçantë në përmbajtje të njoftimit, që i njoftohen fituesit dhe që konsiderohen pjesë e kontratës për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike të nënshkruar ndërmjet KESH dhe pjesëmarrësit të regjistruar.

3.18 Mjete elektronike: janë pajisjet/programet elektronike që ndihmojnë për realizimin/publikimin/komunikimin/përpunimin/ruajtjen e të dhënave/njoftimeve gjatë zhvillimit të një procedure tregtimi/furnizimi të energjisë elektrike.;

Neni 4

Parimet kryesore të ushtrimit të aktivitetit të tregtimit/furnizimit të energjisë elektrike

4.1 Tregtimi/furnizimi i energjisë elektrike nga KESH do të realizohet në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe parimet e ruajtjes së konfidencialitetit.

4.2 Tregtimi/furnizimi i energjisë elektrike duhet të synojë realizimin me efikasitet të të ardhurave dhe optimizimin e portofolit të KESH bazuar në parimet bazë të zhvillimit të biznesit.



Neni 5

Regjistrimi në regjistrin e pjesëmarrësve në procedurën e tregtimit të energjisë elektrike

5.1 Çdo subjekt i licencuar, vendas apo i huaj, që dëshiron të regjistrohet në regjistrin e pjesëmarrësve në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike, së bashku me formularin e plotësuar sipas formatit të publikuar nga "AK" si kusht për regjistrimin si pjesëmarrës në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike, duhet të paraqesë pranë "AK" edhe dokumentacionin e nevojshëm administrativ që vërteton personalitetin juridik dhe zotësinë ligjore për pjesëmarrje në procedura të tregtimit të energjisë elektrike, nga institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku janë regjistruar dhe ushtrojnë aktivitetin apo ka selinë e tij qendrore si me poshtë vijon:

1. Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtar gjyqësor të shtetit përkatës në të cilin shoqëria është regjistruar.
2. Licencën për tregtimin/furnizimin e energjisë elektrike të lëshuar nga autoritete përgjegjëse.
3. Dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës të cilët vërtetojnë se:
 - a. Subjekti i licencuar nuk është në proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;
 - b. Subjekti i licencuar dhe administratori nuk janë të dënuar nga gjykata dhe as nuk ndiqen penalisht për shkelje penale për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit);
 - c. Subjekti i licencuar ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore në përputhje me legjislacionin e shtetit përkatës;
 - d. Pasqyrat financiare të subjektit të licencuar, të vitit të fundit, të certifikuar sipas rregullave të shtetit përkatës ku shoqëria ushtron aktivitetin.

5.2 Pas paraqitjes dhe vlerësimit si të rregullt të dokumentacionit të parashikuar në pikën 5.1, "AK" kualifikon subjektin e licencuar, i cili ka kërkuar pjesëmarrjen, dhe harton, mban dhe përditëson regjistrin e pjesëmarrësve. Në çdo kohë pjesëmarrësi i regjistruar mund të kërkojë KESH pranimin e largimit dhe për pasojë heqjen e tij nga lista e pjesëmarrësve të regjistruar.

5.3 Dokumentacioni sipas pikës 5.1 do të përtërihet kryesisht, nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar brenda muajit Dhjetor të çdo viti dhe do të jetë i vlefshëm për vitin pasardhës. Mos dërgimi i dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar sjell për pasojë çregjistrimin e pjesëmarrësit të licencuar nga regjistri i AK.

5.4 Subjekti i licencuar që shpreh për herë të parë interesin e tij apo rishtazi kërkon të regjistrohet si pjesëmarrës në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen nga "AK", do të paraqesë pranë këtij të fundit dokumentacionin e parashikuar në pikën 5.1.

5.5 Pas përfshirjes në regjistrin e pjesëmarrësve, "AK" në të gjitha procedurat e zhvilluara nga ana e tij, i dërgon ftesë/ofertë pjesëmarrësve të regjistruar.

5.6 Në çdo rast dhe në çdo kohë "AK" mund të kërkojë pjesëmarrësve të regjistruar, paraqitjen brenda 30 ditëve dhe jo më shumë se 3 here në vit, të secilit nga dokumentet e parashikuar në pikën 5.1/1, 5.1/2, 5.1/3/b dhe 5.1/3/c të këtij neni, me qëllim verifikimin e statusit ligjor të subjektit. Mos dërgimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar sjell për pasojë çregjistrimin e pjesëmarrësit të licencuar nga regjistri i "AK".

Neni 6

Tregtimi/Furnizimi i energjisë elektrike

6.1 Kërkesa/Ftesa për ofertë/Oferta hartohet nga "AK"/"OE" në përputhje me parashikimet në aktet që miratohen me vendim të brendshëm të shoqërisë. Kërkesa/Ftesa për ofertë/Oferta që hartohet nga "AK"/"OE" përmban elementët që garantojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë dhe që nuk shtrembërojnë konkurrencën për të gjithë Subjektet e Licencuara

6.2 "AK" në rastet kur kërkon të shesë apo blejë energji elektrike, do ti dërgojë në rrugë elektronike të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar kërkesën/ftesën për ofertë.

6.3 "OE" në rastet kur vendos të marrë pjesë në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen me mjete elektronike nga subjekte të licencuara, bën të gjitha vlerësimet e nevojshme dhe harton kërkesën/ofertën dhe e dërgon atë pranë subjektit të licencuar sipas formës së kërkuar.

6.4 "AK" në rastet kur kërkon të furnizojë një klient fundor me energji elektrike, do të marrë të gjitha masat në lidhje me ndërtimin e ofertës dhe hartimin e parashikimeve kontraktore që do jenë objekt negociimi me klientin fundor. Rregullat specifike për këtë pikë miratohet në akt të brendshëm të shoqërisë.

Neni 7

Kërkesa/Ftesa për ofertë

7.1 Kërkesa/ftesa për ofertë që AK i drejton Subjektit/eve të Licencuar duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

1. Sasinë e energjisë elektrike në MWh që do të tregtohet;
2. Periudhën e lëvrimit në orë-bloqe orare/ditë/javë/muaj/vit;
3. Siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
4. Piken e lëvrimit të energjisë elektrike;
5. Kriterin e vlerësimit të ofertave;
6. Afatin e dorëzimit të ofertave
7. Vlefshmërinë e ofertave;
8. Të drejtën e ankimit

7.2 Në çdo rast, AK mund të parashikojë edhe kërkesa dhe/ose kushte të tjera, të cilat duhet të jenë të arsyeshme, jo-diskriminuese, në funksion të procedurës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Deklarata e konfliktit të interesave

8.1 Çdo individ i angazhuar në proceset që zhvillon "AK" për tregtimin/furnizimin e energjisë elektrike do të nënshkruaj deklaratën me ane të se cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me pjesëmarrësit e regjistruar në KESH, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave. Nëse një individ i angazhuar në proceset që zhvillon "AK" është në kushtet e konfliktit të interesave me një nga pjesëmarrësit e regjistruar në KESH sh.a, atëherë "AK" do të bëjë zëvendësimin e tij.

Neni 9

E drejta e ankimit

9.1 Çdo subjekt ofertues, referuar parashikimeve në ftesën për ofertë, mund të kërkojë rishikim të njoftimit të rezultatit të pjesëmarrjes në procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, kur gjykon ose krijon bindje (bazuar në prova) se njoftimi përfundimtar i bërë nga AK në lidhje me kërkesën/ofertën e tij, është i pabazuar dhe në kundërshtim me këtë rregullore dhe parashikimet e kërkesës/ftesës për ofertë.

Neni 10

Monitorimi i procedurave

10.1 Të gjitha procedurat e tregtimit/furnizimit me energji elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë procedurë tregtimi/furnizimi me energji elektrike nuk lejohet të kryhet pa dokumentacionin shoqëruar të kërkuar.

10.2 KESH ka detyrimin t'i japë në mënyrë transparente çdo institucioni të ngarkuar me ligj të gjithë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar për sa i përket zhvillimit dhe pjesëmarrjes në



procedurat e tregtimit të energjisë elektrike si edhe procedurave të ndjekura për furnizimin me energji elektrike.

Neni 11 Sanksione

Për shkelje të ketyre rregullave dhe kur veprimi nuk përbën vepër penale ose kundërvajtje administrative, organet drejtuese të KESH zbatojnë parashikimet e akteve e tjera që rregullojnë aktivitetin e KESH.

Neni 12 Miratimi dhe ndryshimi

Këto rregulla miratohen, ndryshohen dhe shfuqizohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të KESH sh.a.

Neni 13 Dispozita kalimtare

12.1 Ngarkohet Administratori i shoqërisë që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të kësaj rregulloreje dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të shoqërisë, të miratojë aktet e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje (manualet, procedurat, formularët, kontratat tip etj)..

12.2 Për periudhën deri në përfundim të afatit të mësipërm, shoqëria KESH sh.a të vijojë zhvillimin e procedurave të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike sipas parashikimeve të rregullores së miratuar me vendimin e Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë Nr.2762/8, datë 06.06.2018 "Mbi miratimin e rregullores së tregtimit të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a"

Neni 14 Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë pas miratimit dhe publikimit në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë (www.kesh.al).

